123

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

Nr.Prot. 3392
Indeksi : I

Tiranë, më 10.03.2017

Lënda: Përcillet përgjigje për informacionin e kërkuar nga Res Publica.

ZOTIT GENTIAN KËRRI
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË E SIPËRMARRJES

I nderuar zoti Sekretar i Përgjithshëm,

Në përgjigje tuajës Nr.prot.610/1, datë 04.02.2017, lidhur me kërkesën nga Qendra "Res Publica" për informim në lidhje me mbulimin e zërave të ndryshëm: publikime, udhëtime, konsulencë dhe ekzistencën e ndonjë kontrate ndërmjet qeverisë shqiptare dhe Developing Markets Associates për forumet e promovimit të Shqipërisë: "Hong Kong – Albania Trade & Investment Forum 2015" dhe "Singapor – Albania Trade & Investment Forum 2017" ju bëjmë me dije, se:

> Lidhur me Forumin e Investimeve dhe Tregtisë Shqipëri - Singapor i gjithë komunikimi, koordinimi, mbarëvajtja dhe zhvillimi ka qenë jashtë kompetencave dhe komunikimeve të strukturave të MPJ.
>
> Ministria e Punëve të Jashtme nuk ka informacion lidhur me ekzistencën e ndonjë marrëveshje apo kontrate mes qeverisë shqiptare dhe Developing Markets Associates.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

GAZMEND BARBULLUSHI

Miratoi: Blerta Kadzadej, Drejtore e Përgjithshme
Miratoi; I.Zhupa, Drejtor
Punoi: N.Maçi, Përgjegjëse Sektori

MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME, BULEVARDI GJERGJ FISHTA, TIRANE
TEL: (+355) 4 2 364090/EXT.79110, 79139. FAX: (+355) 4 2262085/2262084

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 610/1 Prot. Tiranë, më 6 / 2 /2017

Lënda: *Përcillet kërkesa për informacion dërguar nga Qendra "Res Publica"*

Drejtuar: **KOORDINATORIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**
MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

Për dijeni: **Z. DORIAN MATLIJA, DREJTOR EKZEKUTIV**
QENDRA "RES PUBLICA"
Blvd "Gjergj Fishta", ND.24, H.3, Ap.44

TIRANË

Në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në datën 27.01.2017, është depozituar kërkesa "*Për informacion dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit*" e dërguar nga Qendra "Res Publica".

MZHETTS, pasi mori në shqyrtim kërkesën, informoi kërkuesin lidhur me shpenzimet për mbulimin e udhëtimit të ministrit për pjesëmarrjen në forumin ekonomik të Singaporit, ndërsa në lidhje me pjesën tjetër të kërkesës, sa i përket mbulimit të zërave për publikime, konsulencës apo vënien në dispozicion të marrëveshjes mes qeverisë dhe Developing Markets, konstatoi se nuk e zotëron këtë informacion.

Sa më sipër, si dhe bazuar në nenin 12 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku citohet se: "*.....Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuesin.*", po ju përcjellim, për trajtim kërkesën për informacion (bashkëlidhur).

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

GENTIAN KËRI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK TIRANË

928

010/1
Dërguar për kompetencë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 610/2 Prot. Tiranë, më 6/2/2017

Lënda: *Dërgim informacioni*

Drejtuar: **Z. DORIAN MATLIJA,**
DREJTOR EKZEKUTIV
QENDRA "RES PUBLICA"
Blvd "Gjergj Fishta", ND.24, H.3, Ap.44

TIRANË

Z. Matlija,

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, me nr. Prot. 610, datë 27.01.2017 (të MZHETTS), ju bëjmë me dije se, nga verifikimi i dokumentacionit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ka mbuluar shpenzimet e hotelit dhe biletës së udhëtimit me avion të Ministres. Përdorimi i fondit për këto shpenzime është kryer në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik, me procedurë "Prokurim me vlere te vogel", në sistemin elektronik të Agjencisë së Prokurimit Publik, në adresën www.app.gov.al

Në lidhje me pjesën tjetër të kërkesës, sa i përket mbulimit të zërave për publikime, konsulencës apo vënien në dispozicion të marrëveshjes mes qeverisë dhe Developing Markets, MZHETTS, pasi mori në shqyrtim kërkesën, konstatoi se nuk e zotëron këtë informacion.

Sa më sipër, si dhe bazuar në nenin 12 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku citohet se: "*.....Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuesin.*", kërkesa juaj i është përcjellë Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

GENTIAN KËRI